



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Nr. Protokolit:

Data: 16.09.2024

Për: Anëtarët të Kuvendit të Komunës së Pejës

Të nderuar anëtar/e

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1. të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 28, paragrafi 1 i Statutit nr. 01-2020 të Komunës së Pejës dhe në bazë të nenit 11, paragrafi 1.2, neni 15, paragrafi 1 të Rregullorës nr.02-2021 për Punën e Kuvendit të Komunës së Pejës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ju:

THËRRET

Të merrni pjesë në mbledhjen e VIII të rregulltë për vitin 2024, të Kuvendit të Komunës së Pejës. Mbledhja do të mbahet me dt. 27.09.2024 (Premte), ora: 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Vërejtje: Kuvendi i Komunës mbanë të drejtën për ta aplikuar nenin 45. paragrafin 3. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nëse kjo gjë shihet e nevojshme.

RENDI I DITËS

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të K.K. Pejë, dt. 26.07.2024.
4. Shqyrtimi dhe rekomandimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Pejës 2025-2027.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Fatmir Zymberi, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ajmon Sefa, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Sali (Shaban) Qelaj, me qëllim të përmbushjes së interesit publik.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Drejtorisë së Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2023 dhe 2024.
9. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e Komiteteve Konsultative për vitin 2023 dhe 2024.

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433

10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të KKSBB-së për vitin 2023 dhe 2024.
11. Shqyrtimi dhe miratimi për dhënie në diskutim publik të Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026.
12. Shqyrtimi dhe miratimi për dhënie në diskutim publik të Draft Rregulloren për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës.
13. Shqyrtimi i informatës nga DKA për fillimin e vitit shkollor.

14. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar (*për tu dorëzuar të Sekretari jo më vonë se të Enjeten me dt. 26 Shtator 2024*).
15. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

KRYESUES I KUVENDIT
z. Rexhep Kurtbogaj



SKUPŠTINA OPŠTINE PEĆ

Br. Protokola:

Datum: 16.09.2024

Za: Članove Skupštine Opštine Peć

Poštovani članovi/članice,

Na osnovu člana 43, stav 43.1. Zakona o Lokalnoj Samoupravi, člana 28, stav 1 Statuta br.01-2020 Opštine Peć i na osnovu člana 11, stav 1.2, člana 1.5 stav 1 Pravilnika o Radu br.02-2021 Skupštine Peć, Predsedavajući Skupštine vas:

POZIVA

Da učestvujete na VIII redovnoj sednici Skupštine Opštine Peć za 2024. Godinu. Sednica će se održati dana 27.09.2024 (Petak), u 10:00 časova, u sali Skupštine Opštine Peć.

Napomena: Skupština Opštine zadržava pravo primene člana 45 stav 3 Zakona o Lokalnoj Samoupravi, ako se to smatra potrebnim.

DNEVNI RED

1. Učešće i odsustvo članova na sednici.
2. Učešće javnosti i delegacija.
3. Razmatranje i usvajanje zapisnika Skupštine Opštine od 26.07.2024.
4. Razmatranje i preporučivanje usvajanja budžeta Opštine Peć za period 2025-2027.
5. Razmatranje i usvajanje predloga Gradonačelnika Opštine za razmenu opštinskih nekretnina za privatnu imovinu g-dina Fatmir Zymberi, sa ciljem ispunjavanja javnog interesa.
6. Razmatranje i usvajanje predloga Gradonačelnika Opštine za razmenu opštinskih nekretnina za privatnu imovinu g-đe Ajmon Sefa, sa ciljem ispunjavanja javnog interesa.
7. Razmatranje i usvajanje predloga Gradonačelnika Opštine za razmenu opštinskih nekretnina za privatnu imovinu g-dina Sali (Shaban) Qelaj, sa ciljem ispunjavanja javnog interesa.
8. Razmatranje i usvajanje predloga Direktorata za Administraciju i Gradonačelnika Opštine Peć i usvajanje predloga DA za naknadu predsedavajućim Lokalnih Odbora za 2023 i 2024. Godinu.
9. Razmatranje i usvajanje predloga Gradonačelnika Opštine Peć o naknadi članovima OOBZ-a za 2023 i 2024. Godinu.
10. Razmatranje i usvajanje davanja na javnu raspravu nacрта Plana protiv prekidanja školovanja i neupisivanja u škole 2024-2026.
11. Razmatranje i usvajanje davanja na javnu raspravu nacрта Pravilnika o transportu paucima na teritoriji Opštine Peć.

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Adresa: Rr. Hasan Prishtina

Tel: 03820043433

12. Razmatranje informacija ODO o početku školske godine.
13. Pitanja i predlozi u vezi rada Opštine, istaknuti od članova, po redosledu po kome su primljeni. (Dostaviti Sekretaru ne kasnije od četvrtka, 26. Septembra 2024).
14. Pitanja istaknuta od strane predsedavajućeg ili članova Skupštine.

PRESEDAVAJUĆI SKUPŠTINE
G-din Rexhep Kurtbogaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 060/01-54843

Pejë, datë: 26 korrik 2024

PROCESVERBAL

Nga takimi i **-VII-** të i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **26 korrik 2024**, me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: pos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z. Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj. Donjeta Morina, asistente e kryesuesit, znj. Florinda Berisha: përfaqësues të ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroi pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 33 anëtarë prezent.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

REND DITE

1. Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.
2. Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të K.K. Pejë, dt. 28.06.2024.
4. Shqyrtimi dhe Miratimi i vendimit për projektin "Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor".
5. Shqyrtimi dhe miratim i Raportit të vlerësimit të dëmëve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit tjera të periudhës kohore korrik 2023 - qershor 2024.
6. Shqyrtimi i themelimit të grupit punës për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.

7. Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i Draft Strategjisë Komunale kundër dhunës në Familje 2024-2027 dhe Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje 2024-2027.
8. Shqyrtimi i raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2024.
9. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2023 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2023.
10. Shqyrtimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshëmirsë dhe testit të maturës.
11. Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2024.
12. Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:
13. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Në takim munguan z.Rrustem Berisha dhe z.Granit Kelmendi.

2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet.

Nuk ka pasur.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të K.K. Pejë, dt. 28.06.2024.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent u miratua procesverbali i KK Pejë i dt.28.06.2024.

4.Shqyrtimi dhe Miratimi i vendimit për projektin "Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor".

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e kemi diskutuar edhe në KPF kur drejtori ka prezentuar këtë strategji për përkrahjen e fermerëve.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 27 votë pro, 6 votë të përmbajtur, u miratua vendimi për projektin "Përkrahja e fermerëve/bujqve në zonat rurale me mekanizëm bujqësor".

5.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të vlerësimit të dëmëve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit tjera të periudhës kohore korrik 2023 - qershor 2024.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: është raport që plotësohet nga komisioni i forumar nga kryetari në rastin e fatkeqësive për vlersimin e dëmëve. Është një dokument që e kemi shqyrtuar edhe në takimin e KPF-së i cili ka marrë sugjerime nga anëtarët që të plotësohet. Pastaj dokumenti ka ardhur i plotësuar me rekomandimin që ju është dhënë nga anëtarët e KPF-së.

Z.Naim Bytyqi: këtë raport e lexova me vëmendje dhe këtu thotë se 66 kërkesa janë shqyrtuar dhe kanë arritur me u pranuar nga ana e komisionit. Mirëpo këtu në rendor nuk është 66 por është numri 69. Thotë: tri kërkesa kanë ardhur mrenda KPF-së, edhe gjatë mbledhjes së KPF-së janë pranuar edhe 6 kërkesa, më intereson a ka qenë komisioni prezent në KPF? Po ashtu shqetësimi im është se kjo listë që 3 here po ndryshohet, shumica e parë ka qenë 71 mijë euro, shumica tjetër

118 mijë euro, 54 mijë euro kanë qenë shumat e pavendosura dhe pastaj janë vendos më vonë edhe në fund ka arrit shumen 173 mijë euro. Më intereson për çka janë bo këto dëme? A kanë qenë në bujqësi? A ju ka prish diku keri? Ta dim saktë se për çka janë pagu, sepse për mos me lshu unë me përmend emra dhe përsone fizik, mua më interson saktë për gjithësecilin se qfarë dëme j'u kanë shkaktuar! Edhe unë nuk e di si ka kalu në KPF, dhe i ftoj koleget mos me votu ketë raport pa u sqaru keto kërkesat që unë po i boj këtu sot.

Znj.Mubera Belegu: unë në lidhje me ketë pikë të komisionit komunal e kam vërejt që duhet përmirësim në të shkruar, mirëpo specifikimi prap po mbet njejt. E kemi vlerën e dëmit mirëpo nuk është e specifikuar se për çfare dëmi bëhet fjalë, pra është mase e nevojshme me qenë edhe një kolonë ku do të ceket se çfarë është dëmtuar. Po ashtu askund nuk shoh që kanë qenë prezent kryetarët e bashkësive lokale, edhe vitin e kaluar e kam cekë që kryetarët e bashkësive lokale duhet me qenë prezent me komisionin kur ndodhin fatkeqsi, për me dit se edhe ata se çka po ndodh me bashkësinë e tyre! Për ketë arsye mendoj që kjo nuk duhet të votohet të plotësohet edhe kjo kolonë të specifikohet se çka është dëmtuar sepse ka me shku në qeveri dhe për ketë arsye mundet me u kthy prapa.

Z. Berat Ganiqi: në KPF ketë raport e kemi kalu me një vërejtje për me sqaru se në çfarë date janë duke u kompenzu vërshimet sepse këtu thuhet: Korrik 2023-Qeshor 2024. Po ashtu nuk specifikohet data fare se për cilat vërshimet, aty ka pas edhe të komunave tjera të cilet kanë thonë jetojmë në Pejë. Këto sqarime duhet me u bo, sespe janë të pa qarta dhe e dini edhe ju kryesuse që ka kalu me vërejtje. Kur u kthy prap vetëm nr i protokollit është shtu pa ndjonje sqarim shtesë, kjo siq tha edhe znj. Mubera, shkon edhe në qeveri dhe atje ata do t'i kqyrin me detaje. Unë, nuk du me paragjyku se a u dëmtu dikush a po nuk është dëmtu, aty e din më së miri komisioni të cilet e kanë bo vlerësimin, mirëpo duhet me i pas keto sqarime na si asambleista kur flasim për vërshime se për çfarë vërshime po flasim!

Z.Nezir Jahmurataj: e kam pa listen e njerzve të dëmtuar gjatë një viti si nga breshëri si nga vërshimet, si nga era, është mirë që aty e kanë cekë por e kisha lut komisionin që të jetë më gjithë përfshirës nga të gjitha subjektet sespe është ma real. Po ashtu kisha kerku që të kompenzohet dëmet e vitit të kaluar që kanë qenë më të mëdhaja, ndërsa këto vlerësimet e ketij viti të jenë vlerësime më reale.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: komisioni i vitit të kaluar është vlersu si komisioni shembull për vlerësimin e dëmeve. Qeveria e ka nxjerrë një vendim mirëpo në atë vendim nuk është përfshi periudha e dëmeve që kanë ndodhë në komunën e Pejës dhe qytetarët kanë mbet pa u kompenzu.Edhe ky vlerësim thash këta nuk ja kanë qit vulen , por është vlerësu dëmi për afërsisht sa është dëmi i ekonomive familjare. Ky vlerësim shkon në komisionin ndërministror dhe ata në bazë të dokumentacionit që e kanë i vlerësojnë.

Nga të gjithë anëtarët prezent me 17 votë pro, 11 votë kundër, 2 votë të përmbajtur, dhe 3 antarë nuk kanë marr pjesë në votim , miratohet raportit i vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore dhe fatkeqësit tjera të periudhës kohore korrik 2023 - qershor 2024.

6.Shqyrtimi i themelimit të grupit punuës për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.

Kryesusi Z. Rexhep Kurtbogaj: para përfundimit të çdo viti e kemi berë obligim qe ta kemi të miratuar planin e punës së kuvendit, anadaj sot duhet që ti propozojmë antarët nga kuvendi që të jenë pjesë e komisionit për hartimin e planit të punës të kuvendit. Komisioni përbehet nga 7 antarë, do të ketë përfaqsim nga të gjitha subjektet politike. Kryesusi i kuvendit shkonë me automatizëm, pastaj 6 antarë tjerë dhe 1 antarë nga shoqëria civile apo partnerë të jashtëm, në këtë rast e kemi shërbimin e kuvendit.

Antarët e propozuar:

Islam Husaj – LDK
Naim Bytyçi – AAK
Hidaete Nikqi – LVV
Fatime Shala – PDK
Izet Kojic – BIP

Me 30 vota pro, kundër nuk ka, përmnajtur nuk ka, 3 antarë nuk kanë marrë pjesë në votim, miratohet përberja e komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025.

7.Shqyrtimi dhe miratimi pas diskutimit publik i Draft Strategjisë Komunale kundër dhunës në Familje 2024-2027 dhe Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje 2024-2027.

Kryesusi Z. Rexhep Kurtbogaj: Eshtë një draft plan që ka kaluar edhe përmes diskutimit publik, gjithashtu është edhe një material i cili është derguar me kohë tek antarët e kuvendit.

Me 31 vota pro, kundër nuk ka, përmnajtur nuk ka, 2 antarë nuk kanë marrë pjesë në votim. Miratohet Draft Strategjia Komunale kundër dhunës në Familje 2024-2027 dhe Plani i Veprimit për parandalimin e dhunës në familje 2024-2027.

8.Shqyrtimi i raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmuajorin e parë, janar - qershor 2024.

Z. Naim Bytyqi: sa i përket raportit të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmuajorin e parë, mua me intereson kodi ekonomik 50212, liçensa për reklama një publikim në pronë publike është e shënuar dy herë, ne njerën kategori nuk ka te hyra fare, ndersa ne tjetrën ka. Gjatë raportit tre mujorsh kur ka ardhur para 3 muajave, zyrtarja për financa tha së mund të jetë gabim teknik, por mua sot me intereson a është gabim teknik apo nuk ka të hyra, sepse njera kategori është 24.000 euro të hyra dhe tjetra 0 te hyra për 6 mujorshin e 2024. Sa i përket raportit të shpenzimeve gjatë 3 viteve i keni cek akomodimi për udhetime zyrtare, kodi ekonomik 13142, do të thotë këtu po kalonë parashikimi për 100 % herë edhe më shumë, do të thotë po shpenzoni shumë, posë me qenë ministria e punëve të jashtëm me gjitha këto levizje me gjitha këto shpenzime. Shërbimet e

përfaqsimi të avokaturës edhe kjo në rritje, blerja e kompjuterëve ketu sipas parashikeve është 42, ndoshta aty ka edhe arsye, nuk e di, paisjet tjera me vlerë 1000 euro edhe këtu sigurisht ka arsye, sigurimi i automjeteve, mua me intereson tek sigurimi i automjeteve a janë të regjistruara a nuk janë. Tek kategoria tjetër, investimet kapitale këtu thotë 22.86 % janë shfrytëzuar. Mua me interesonë si ka me qenë investimi për 2024 po shkon vera, nga kushtet klimatike ndalojnë që ti kryejmë dhe ti realizojmë ato që i kemi parapa për 2024. Do të thotë është shumë shqetësuesë investimet kapitale të cilat komuna nuk ka arritë me i realizu vetem 22 % jemi ne muajin e 7.

Z. Berat Ganiqi: kisha mu ndalë pakë tek mirëmbatja dhe riparimi i automjeteve të cilat janë 32,644.60 për këtë 6 mujorin e parë të vitit 2024. Cdo vitë është parapa blerja e veturave dhe me sa di, veturat vitin e kaluar janë blerë të reja dhe komunes po i kushton kogja shumë mirëmbatja dhe riparimi i tyre 32.644 euro. Do të thotë e kaluar për disa euro edhe 6 mujorin e vitit të kaluar. Është interesante poashtu keni dy kode buxhetore, tek shpenzimet e derivateve, tek derivatet për gjenerator i keni parap 25.000 euro ndersa i keni shpenzu 0 euro. Poashtu në kodin tjetër buxhetor e keni berë derivate për automjete gjenerator dhe makina 123.603 euro. Do të thotë edhe ketu prap keni vendosur derivate për makina, i keni përfshi edhe gjenerator edhe pse e keni një kod tjetër buxhetor. Poashtu siç e tha edhe kolega Z. Naimi me heret ka shpenzime në normen për përfaqesim të avokaturës. Unë e di që përfaqesimet në avokatur kushtojnë kogja, por e di që edhe landë komuna e Pejës është tu i humb shumicën. Për shkakë që vetëm me këtë kontratën kolektive po shihet sa jemi dukë i humbë. Është mirë me e bë një marrëveshje me avokatin kush e përfaqeson komunën, me bisedu edhe me nderru këtë tarifë, për shkakë së ka tejkalu shumë, vitin e kalum ka pasë shumë ma pak shpenzime në 6 mujorin e parë, këtë vitë ka shumë e ma shumë. Vretja tjetër është tek të hyrat për 500.000 euro ma pakë ka te hyra këtë vitë tek tatimi për pronë. Mendojë që mbledhje e mos tatimeve është një problem i madhë, gjithashtu edhe tek gjobat e inspektoriatit, kemi më pakë të hyra se sa viteve të kaluara. Këto janë vretjet tona dhe pres reflektim.

Z. Drin Veselaj: përveç këtyre që i cekën kolegët, mua me intereson ta bëjë një pyetje tek transferet dhe subvencionet në kuadër të zyrës së kryetarit. Për shembull vitin e kaluar kanë qënë 181.000 euro deri në muajin e 6, janë planifiku 290.000 euro. Nderësa këtë vitë deri ne muajin e 6 janë shpenzu 260.000 euro. Pra për 6 muaj janë shpenzu transferët dhe subvencionet në një masë të madhë. Cka don me bo kryetari tash këto 6 muajt tjerë?

Znj. Hajrije Haxhijaj: sa i përkëtë raportit të të hyrave dhe shpenzimeve për periudhen janar-qeshor, po ju tregojë që nuk jau kemi dergu si material, por në këtë muaj na kanë arritë edhe gjobat në trafik edhe gjobat nga gjykata. Komplet gjobat nga gjykata për 6 mujorin janë 33.995 dhe gjobat në trafikë janë 410.003 euro. Sa i përkëtë pytjes së deputetit që janë dy kode ekonomike, duke marrë parasysh së të hyrat janë paraqitur në bazë të drejtorive, do të thotë kodet ekonomike janë në dy drejtori. Është tek infrastruktura rrugore ku ceket liçesa për reklamim në prona publike ku janë inkasu 24.000, këtu janë lejet për postat, antenat që e kemi leshuar hapsirat publike, këto i mbledhë drejtorja e shërbimeve publike, infrastruktura rrugore. Tek çeshtjet pronësore që është i cekur kodi ekonomik i njejt, këto janë liçesat për shfrytëzimin e hapsirave

publike rreth lokaleve, që për fat të keq por unë po e pranojë nuk janë evidentuar në kodin përkatës, gjitha këto të hyra kan hyrë në kodin qeraja nga objektet publike. Tek pytja tjetër që ishte rreth planifikimit të kodeve ekonomike në mallra dhe shërbime, duhet cekur që plani kontabel në vitin 2023, kur e kemi planifiku buxhetin e vitit 2024 ka pësuar ndryshime. Janë kode ekonomike që në të ardhmen nuk kemi nevojë që planifikojmë vetëm derivate për gjenerator, por shuma ka më u përfshi në derivate për automjete gjenerator dhe makina që e kanë bërë si kod me të përgjithshme. Sa i përketë udhetimeve zyrtare normal kemi pasë shpenzime më të mëdhaja, qëllimi kryesor është mos të tejkalohet.

Kryetari Z. Gazmed Muhaxheri: ky 500.000 euro që po mbledhet me pak në tatimin në pronë, është vendimi i qeverisë që me heq kushtëzimin për regjistrim të automjeteve, do të thotë efekti i heqjes së këtij kushtëzimi, ka rezultuar në këtë 6 muaj 500.000 euro më pak të hyrave vetanake. Kemi me u mundu deri në fund të vitit më e kompenzuar këtë punë, duhet me ju dergu veretje personave që nuk e pagujnë tatimin me rregull.

Z. Naim Bytyqi: po i drejtohem zyratës, reklamat do të thotë janë kompetencë sa mundem me ditë unë, drejtorisë për shërbime publike, cilat janë zero. Njera kategori është zero ska të hyra, njera i ka 24.000. Mua po me intereson reklamat, billbordat në rrugë a ka të hyra nga to apo nuk ka?

Znj. Hajrie Haxhijaj: po janë të regjistruara si të hyra në kodin qeraja nga objektet publike. Një pjesë është e parapamë në drejtorinë e shërbimeve publike, pjesa tjetër e shfrytëzimit të hapsirave është e parapamë në çështje pronësore.

Z. Naim Bytyqi: a duhet me i nda apo duhet kodin zero me fshi krejt, dhe për regjistrim të automjeteve e kërkova një përgjigje, a janë të regjistruara automjetet e komunës?

Znj. Hajrie Haxhijaj: duhet me i nda por po e kemi një problem teknik rreth kësaj.

Kryetari Gazmed Muhaxheri: janë të regjistruara ato që kanë regjistrim, këto tjerat që ju ka kalu regjistrimi janë ankesat në OSHP dhe janë 15 vetura që nuk janë të regjistruara dhe nuk dalin në qarkullim.

Z. Berat Ganiqi: sa i përketë vendimit të qeverisë, ai vendim ka qenë për mu pëshendet, për shkakë që nuk mundesh me kushtëzu qytetarin me diçka që ka të bëjë me krejt tjetër çka. Mundesh me kushtëzu diçka që lidhet me tatimin në pronë, por përm me regjistru veturën me pagu faturën e mbeturinave, me pagu faturën e tatimit është e kundershtshme dhe antikushtëtuse, shkelje e të drejtave të njeriut. Është obligim i komunës për me mbledhë tatimin dhe jo i qeverisë.

Z. Drin Veselaj: 500.000 euro janë me pak në inkasimin e tatimit në pronë, ju thatë që prej që është heq kushtëzimi. Më sa unë e di kushtëzimi është heq që 3 vite, kurse vitin e kaluar në kemi diskutu këtu, jeni krekosë ju për inkasim të tatimit në pronë deri në pikë të fundit, çfarë ndodhi

tash?

Kryetari Z. Gazmed Muhaxheri: vitin e kaluar kemi pasë tejkallim 1.000.000 euro të hyrave vetanake. Edhe këtë vitë e shikojmë këtë punë, qytetarët me siguri vetdisohen kur vinë tek shtatori e pagujnë për mos me ju ngritë kamata.

Z. Nezir Jahmurataj: unë po kyçem në këtë pjesën e dytë, e pashë që grumbullimi i të hyrave nga tatimi në pronë është me i vogël këtë vitë, por po më intereson vitet e më parshme, kanë qenë të kushtezuar qytetarët me vetura, i kam parë disa përsone ose kompani që vepronë në territor të komunës së Pejës, që kanë tatim në pronë jashtëzakonishtë shumë. Si i kanë regjistru veturat përpara sepse i kanë pasë 40.000 euro borxhe komunës?

Kryetari Z. Gazmed Muhaxheri: e dinë edhe vetë, kanë shku në Deqan i kanë regjistru dhe këtu kanë mbetë me tatim. Kemi njerëz që nuk janë social ndaj shoqërisë dhe mundohen me ju ikë tatimeve.

9.Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2023 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2023.

Z. Labinot Panxha: sa i pëkëtë kësaj pikë të rendit të ditës, është shumë e rëndesishme të potencohet në fillim që komuna vite me rradhë nuk është duke i zbatu rekomandimet e auditorit të përgjithshëm. Për vitin 2023 janë 8 te gjetura disa prej të cilave do ti diskutojë unë me siguri edhe kolegët e tjerë. Raproti i auditorit për vitin 2023 e paraqet komunën e Pejës siç është me së keqi dhe atë duke e pëcaktuar me opinion të kualifikuar. Kryetari i komunës nuk ka mundur të pëmisohet ne disa fusha siç është fusha e prokurimit publik, ngasë nga ato pak monstra të cilat auditori i ka këkuar ka gjetur shumë parregullsi. Prokurimi publik në komunën e Pejës identifikohet me shkelje ligjore, ku në 7 procedurat e prokurimit hapet tenderë pa berë zotimin e mjeteve dhe për kundër faktit që për ato projekte ka mjete të destinuara mjaftushëm ne ato kode buxhetore. Mirëpo komuna zoton vetem 10 % të shumës totale të dedikuar për ato projekte dhe kjo sigurishtë behët m qëllim që operatorve ekonomik të mos ju behën pagesat, sipas kontratave dhe afateve kohore. Gjetja tjetër është së komuna me 16 raste ka shkelur rregulloren për shpenzimin e parasë publike duke i berë zotimet e mjeteve pasë pranimit të faturave, në vend që të parashihet vlera për sherbimin e caktuar, komuna zgjedh metodë më të shkurtë të furnizohet me mallë apo sherbime të caktuara ende pa e ditur se sa kushton ai sherbim. Tjetër e gjetur e cila është shumë me rëndësi është keqpërdorimi në menaxhimin e kontraktimit të qërasë së parkingjevë. Poashtu ne vitin 2021 kuvendi komunal e ka kaluar listën e pronave për dhenjën në

shfrytezim afatshkurtër, me kohë zgjatje prej 3 viteve. Mirëpo këto prona të destinuar për parkingje janë dhënë për shfrytezim me kohë zgjatje prej 10 vitesh, pra komuna ka vepruar me kundërshtim me një vendim që kuvendi e ka aprovuar në muajin prill 2021. Për fund këto keqpërdorime dhe pa rregullsi në komunën tonë një gjë është e sigurtë, së kjo gjendje e krijuar ka ndikuar dhe do të ndikojë drejtëpërdrejtë në mirëqenien e qytetareve tonë.

Kryesusi Z. Rexhep Kurtbogaj: raporti i auditorit nuk thotë që komuna është keq, jemi në top listën komunave me të mira në Kosovë për zhvillimin e procedurave. Raporti i auditorit ka ardhë si pasojë e një efekti zinxhiror që ka ardhë prej terheqjes së mjeteve nga thesari dhe gjykatat për shujtat. Nuk do të thotë që komuna është në gjendje të keqe pse ka ardhur raporti i kualifikum.

Z. Naim Bytyqi: raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të komunës për vitin 2023. Do të thotë zyra kombëtare e auditimit ka nxjerrur këtë raport ku sipas auditoreve ky raport ka nxjerrur një opinion të kualifikum që nenkupton që ka të gjetura të cilat nuk kanë shkuar sipas rregullave financiare. Ky është klasikimi për shpenzime kapitale, pagesa për shujtat jubilarë të cilat janë ekzekutuar. Unë dua të ndalem tek pika e tretë ku janë 5 herë në 5 raste, marrja e mjeteve për një projekt dhe të cilat kanë kaluar për një projekt tjetër. Është një gjë të cilën unë edhe kolegët e mijë, sidomos personalisht unë e kam cekur për gjatë tërë vitit dhe siç e dini në seancën e fundit e cila ishte seanca e jashtëzakonshme, përplasja e cila ndodhi është pikërisht për këto çështje, për arsye që jam munduar rregullativën e pasqyrave financiare të mbrojtë, kjo ka qenë interes i imi, unë menjëherë që ky raport është raporti me i keqi këto 11 vitet e fundit.

Z. Berat Ganiqi: u tha shumë raporti i auditorit në të gjitha pikat ka dalë keqë, këto të gjeturat që kanë qenë. Është edhe mos inspektimi i pronave të pa lujtëshmë që derivon nga ligji të cilin komuna nuk e ka kryer si obligim. Në shumë projekte nuk janë ndarë fondet e mjaftueshme për realizimin e atyre projekteve, në shumë projekte ka vonesa dhe nuk ka ndonjë afat së kur kanë mu kry. Poashtu kisha mu ndalë tek rregulloja e Ministrisë së financave nr.04/2017 mbi kriteret standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ- së. Komuna thotë në tri raste ju ka nda subvencione organizatave qeveritare të cilat sipas ligjit kanë qenë të obliguara më së pari me i dorëzuar raportet dhe shpenzimet që i kanë pasë për vitin paraprak. Kjo është prap një keq menaxhim në kundërshtim me ligjin, dhe çka është më keq nuk keni caktuar person përgjegjës për me i mbikqyrë, nuk dihet as si janë shpenzuar as çka ka ndodhë.

Znj. Hajrie Haxhijaja: sa i përket raportit të auditorit normal që e dimë së opinionit është kualifiku, por opinionit nuk është kualifiku për shkakë të gjeturave, pra opinionit është kualifiku për shkakë të keqklasifikimit i cili ka ndodhë si pasojë e kontratës kolektive. Do të thotë bazë për kualifikim të opinionit është çështja e kontratës kolektive, çështja tjetër është së disa kontrata që janë cekur që nuk kanë pasë disponoshmeri të mjeteve, duke marrë marrë parasysh së shumica e

projekteve kapitale e kanë planin edhe prej të hyrave vetanake. Sa i përketë projekteve kapitale që janë marrë prej një projekti në projekt edhe tek kjo ka reflektu kontrata kolektive.

Z. Drin Veselaj: çfarë ka të bëjë kontrata kolektive me mos zbatimin e rregullorës për dhënien e subvencioneve edhe caktimin e përsëritës i cilit duhet ti mbikqyrë projektet të cilat jepen subvencionet. Ju e keni bërë keqklasifikimin, mos u mundoni më e relativizu çështjen vetëm me kontratën kolektive, sepse janë 12 çështje të ngritura në raportin e zyrës kombetare të auditimit.

Znj. Hajrie Haxhijaja: te raporti i auditorit, tek plani i pasqyrave financiare do të thotë rekomandimet të cilat jepen prej auditoreve në fillimi të raportit të auditorit ceket, kualifikohet opinioni por si bazë e marrin kontratën keqklasifikimit, kontrata kolektive që na atë nuk e kemi bërë si keqklasifikim, ministria i terhekë paratë.

Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri: kontrata kolektive po e kalon gati 13.000.000 euro, ne si komunë kemi bërë marrëveshje, nuk kemi shku me shty këtë kontratën kolektive edhe na u ka sugjeru se nese e pranojmë marrëveshjen gjyqësore komuna i kuresen diku rreth 900 mijë euro. Komuna tjera kanë shku me seanca të rregullta të cilat kjo kontrate kolektive vitin e ardhshëm e merr buxhetin, por na kemi mendu që duhet me i kursy qeto 900 mijë euro . Kjo është bo mbrapsht sepse kjo kontraë është nënshkrua nga dikush tjetër dhe është dasht shpenzimet me i mbulu qeveria, por qeveria nuk ka pas vullnet me i mbulu keto shpenzimet sepse i ka konsideru këto komuna armiqësore dhe që nuk janë komuna të qeverisë!

10.Shqyrtimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshëmirsë dhe testit të maturës.

Znj. Hidajete Nikqi: sa i përketë informatës për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshëmirsë dhe testit të maturës, unë edhe ne KPF kam ngitur një çështje që mirë kjo informatë të jetë e detajuar nga DKA- ja. Sepse sa i përketë përfundimit të vitit shkollor është mirë të tregohet sa nxënës kanë qënë të regjistruar, numri i nxënësve të cilët janë larguar prej shkollës, pastaj numri i nxënësve të cilët janë përsëritës. Poashtu tek testi i maturës dhe testi i arritshmërisë ne e shohim rezultatet sa ka qënë kalushmëria, mirëpo është mirë me qënë një raport me i detajuar edhe të tregohet a ka pasë nxënës të cilët janë largu nga testi, apo nxënës që nuk kanë mundur me ju nënshtrë këtij testi.

Z. Naser Gega: tek çështja të cilën e ngriti kolegja, thuhet së raporti i detajuar përfundon kur hynë të dhënat ne procesin e SMI dhe aty i kemi shenimet e sakta me përsëritës, me vlerësim e me gjini janë të gjitha. Sa i përketë testit të maturës dhe arritshmërisë a janë të gjithë apo jo, ata të cilët i kanë plotësuar kriteret të gjithë i janë nënshtruar testit, kanë qënë 7 raste të cilat nuk kanë mundur me marrë pjesë tek testi i arritshmërisë pjesën e parë, por ju kanë nënshtruar testit pastaj në

pjesës së dytë dhe nga të gjithë ata nxënës që ju kan nenshtru testit asnjë nuk është sanksionu dhe nuk kemi ndonjë informatë tjetër.

11. Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2024.

Znj. Hidajete Kraniqi: në këtë seancë nder pikat e rendit të ditës kemi edhe raportin 6 mujor të drejtorive. Raporti DKA –së është shqetësues lajmi se në vitin shkollor 2023-2024 kemi 500 nxënës me pak se sa një vit më herët, ndër faktorët ky për rënjen e numrit të nxënësve është rënja e natalitetit, migrimi dhe të dyja si pasojë e kushteve sociale -ekonomike. Në këtë aspekt Komuna nuk ka ndërmarr asnjë hap. Përderisa Komunat tjera kanë ndërmarr hapa konkretë duke ndihmuar familjet që lindin dy e më shumë fëmijë me mjete financiare, komuna jonë nuk e ka pa të arsyeshme ta praktikoi këtë stimulim. Si pilot projekt drejtorati i Shëndetësisë me drejtoratin e arsimit ka kryë vizita sistematike në 4 shkolla të Qytetit: Lidhja e Prizrenit, Xhemajl Kada, Asdreni dhe 7 Shtatori. Në nuk jemi të informuar se nga këto vizita sistematike çfarë rezultate shëndetësore kemi tek ata fëmijë dhe a do të vazhdoi projekti i këtyre vizitave në të gjitha shkollat a do të përfshihen në këtë projekt edhe shkollat e vendeve rurale.

Si DKA a keni ndërmarr masa që nga prindërit të mos kërkojnë mjete financiare për regullimin e klasave sia ka ndodhur deri më tani, e që është shfrytëzuar koha kur ata kanë diplomuar dhe për leshimin e deftesave dhe diplomës është dashur pagesa e një shume të caktuar në emër të demeve. Kjo kërkesë do të ishte e drejtë vetëm në rast kur femija shkakton dem dhe pagesa të bëhet në mënyrë individuale. A janë siguruar lëndet djegëse për dimër goft dru, pelet, apo mazut e jo të ndodhur sikur në vitin e kaluar.

Tek Drejtoria e shëndetësisë

Nga lista esenciale në disa prej artikujve nuk është e mjaftueshme kërkesa e terapi për nevojat e pacientëve të cilët kërkojnë ndihmë shëndetësore, për mbulimin e të gjitha QKMF, QMF dhe AMF. Në disa artikuj ose nuk është planifikuar sipas nevojave, ose është keplanifikuar.

Nëse e analizoni tabelën që e kemi paraqitur vet në raport, vërehen artikuj që ekzistojnë në stok, jeni furnizuar edhe këtë vit me të njëjtën, por nuk janë shfrytëzuar, si rezultat del që pacientët detyrohen të blenë vet atë artikull, ose të drejtohen në institucionin detyësor.

Tek Drejtoria për Mireqenje Sociale

Sa i përket subvencioneve të OJQ-ve në si GGA, kemi vizituar disa nga OJQ-të e Komunës tona përderisa isha si kryesuese e këtij grupi nga AAK. Shqetësimet e tyre dhe kërkesat i kemi paraqitur në raportin vjetor në dhjetor të vitit 2023, por në këtë 6-mujorsh nuk po vëret që është marrë parasysh ndonjë kërkesë. Rritja e shumës së subvencioneve sepse mjetet e ndara edhe në vitin e kaluar nuk kanë mjaftuar për nevojat dhe shërbimet që ata kryejnë e që janë të një rëndësie të vogant.

Tek Drejtoria për punë komunale dhe shërbime publike

Është një qësitje që dua ta theksoj, e që është diskutuar me qindra here në këtë asamble e që ka të bëjë me mungesën e ujit të pijes për fshatrat e Lugut të Baranit. Në këtë pranverë është bërë

teme edhe ne media qe për kete ujesjelles është shkele ligji i parkut kombëtar e ka pas debate e deklarime. Unë sot dua ta pyes kryetarin a është ne dijeni se atje ku i keni deguar ju gypat për kete ujesjelles sot nuk ka uje te pijes fare. A e keni menduar e projektuar mirë këte projekt dhe a do te duhej te mbante dikush përgjegjesi sepse jerezit e asaj treve nuk kane uje te pijes. Te merret aq jo seriozisht mungesa e ujit te pijes për 20 fshatra është fyerje për banoret, e aq më e vestir bëhet jeta e atyre banorëve ne këto dit me temperatura deri ne 40 grade. Gjithashtu thuhet se shumica prej rugëve qe kane qenë të planifiuara janë ne fazen e finalizimit, une e potenco i qe ruga ne Kamenica dhe fshati Qallapek as qe ka fillu.

Tek drejtoria për mbrojtje dhe shpetim

Ne raportin 6-mujor te njesia profesionale e zjarrefikseve kan kryer 194 intervenime, prej tyre 146 intervenime zjarri. E dimë qe zjarrefikësit kryejne intervenime te mëdha dhe në shumicen e rasteve e rrezikojne edhe jeten e tyre, por qe atyre ju mungojne mietet mbrojtëse. Përkundër qe e kemi cekë si shqetësim edhe me heret, nuk është ndermarre asnjë masë në përmirësimin e kushteve te punës.

Z. Drin Veselaj: unë do ta ndajë një çështje me ju, plani i punës së kësaj komune karakterizohet me shumë skandale, probleme e së fundi me punësime nepotiste, partiake dhe te pa merituar. Sot e kam të drejtën me fol për personin të cilit i ka ndodhë kjo pa drejtësi, në këtë rast që është bashkëshortja ime. Para dy muajve është hap një konkurs për rekrotimin e punëtorëve në çerdhen Pellumbat e Paqës, dhe si rrjedhojë bashkëshortja ka shprehë dëshirën me apliku. Kur ajo hyri ne test me shkrim, ajo doli e 6-ta me pikët e testit dhe në intervistë ne vendin e 21. Si përfundim aty ku ju nuk keni mundur me ndërhy tek testi me shkrim, aty ka dalë mirë, aty ku ju e keni pasë mundesin me nderhy, aty e keni bë. Prindërit e mijë kanë punuar pa rroga dhe nuk ju kanë nënshtruar askujt, vitet e 90-ta prindi im ka marrë përgjithsi me e udhëheqë instucionin arsimor pa pagës, vetëm që mos me ju nënshtru asnjë llojë presioni, asnjë lloj pushteti. Nuk ka të bejë vetëm me sistemimin e bashkëshortës time, ka të bëj me drejtësinë dhe me uljen e numrit të banorëve ne këtë qytet, sepse aty janë edhe 80 vajza dhe gra të tjera të cilave ju ka ndodhë fati i njejtë, që kanë qënë të mira ne intervista, në test, mirëpo nuk e kanë pasë mundësin me u pranu për shkakë të bindjeve tyre potilike.

Z. Berat Ganiqi: në gjithë këtë raportin e punës një gjë është bë e mirë, është angazhu një inspektor i ndërtimtarisë. Në çështjet e tjera te gjitha kritikate që i kemi pasë, asnjë raport nuk është i inifikuar. Me i shiku raportet ti mendon që janë drejtorit të qyteteve tjera, të komunave tjera, meqenëse asnjë raport nuk është unifikues, dikush përdor llogo, dikush nuk përdor llogo, dikush jep raport të shkurtër. Të gjitha çështjet e tjera e dim ne çka ka në raport dhe çka përfundu. Nuk barazohet askund raporti i planifikuar me raportine punës për 6 muaj.

Z. Labinot Panxha: unë e kam parë një rekomandim të prokurisë themelore në Pejë, ku kërkon prej kryetarit me ndërmarrë masa për disa zyrtar të cilat ju kan ngritur aktakuzat, nuk po bëj

pyetje tendecioze, por po kam deshirë sot me na tregu kryetari ose dikush nga ju emrat se kush janë dhe për çfar janë ngritur ato aktakuza në ekzekutivin e kryetarit.

Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri: vetëm një pyetje për z. Labinot, qysh e ki ti informatën që prokuroria veç kryetarit ja ka dergu letrën, përgjigju para të gjithve, qysh e ki ti si informatë, kur prokuroria vetëm mua me ka shkru letër.

Z. Labinot Panxha: këtë që të pyta e kam lexuar në raport tendin, është e cekur dhe nuk po të pyse asgjë jashtë temës. Nuk po e di kush janë dhe jam kureshtar me ditë, lexoje raportin dhe e vërenë.

Z. Naser Gega: numri i nxënësve në krahesim me vitin e kaluar i bie 2 % të jetë me i vogel. Nese e marrim në nivel kosovë për çdo vitë nga 2 %, numeri i nxënësve në komunës e pejës për 10 vite i bie që është 20 % numer me i vogël. Nese i marrim statistikat e fundit që kanë dalë në opinion, numri i nxënësve në komunë, tek maturantet ishte diku mbi 40 % deri ne 60% shkonte. Rezultatet e vizitave shëndetsore, ky ka qënë një pilot projekt mes drejtorisë shëndetsisë dhe drejtorisë së arsimit, kanë qënë 4 shkolla të qytetit. Të gjeturat e atij raporti janë dukë u përpunu dhe synimi jonë është së gjatë këtij viti të ri shkollor që do të fillojë, gradualisht ta bëjm shtrirjen në gjithë territorin e komunës së Pejës, sepse me të vertetë është tregu i sukseshem. Tek çeshtje e Z. Drinit që e diskutojë për çeshtjen e punësimit, unë nuk mundem me imagjinu një asambleist me arritë deri në këtë pikë me kriju paragjykime te tilla, aspolut nese përputhen me gjethçka me realitetin jo. Ajo që është kryesorja prej qe ka dalë rezultati dhe Z.Drini nuk e ka marrë mundin me ardh me pyte, nese jo me pyte ka pasë të drejtë me bë një ankesë edhe me zgjedh këtë problem.

Znj. Albulena Bajraktari: unë vetë deshta me u ndërlidhë në pjesën e të nderuares asambleiste ku tha që oraganizatat e shoqërisë civile nuk mbështetën financiarisht nga komuna aq sa duhet. Ju rikujtojë që nga kategoria e subvencionit kemi ngritje të buxhetit vitë pasë vitit. Kjo gjë na mundëson përkrahjen me të madhe për kto organizata dhe vetë raporti fletë që kemi ngritje të kategorisë së subvencioneve di dhe janë përkrahur një numer i madh i oraganizatave. Kjo gjë shumë lehtë mund të evidentohet edhe ne drejtori ose nga vetë organizata.

Znj. Hidajete Kraniqi: nuk themë që nuk mbeshteten, drejtoresh ke qenë edhe ne KPP kur e kemi disku këtë çeshtje, ka qenë interes i joni si grup i grave asambleiste, që varesisht prej organiztave që veprojnë me shumë, e një ndër to ka qënë edhe Duart plotë meshirë, që ka kerku një rritje pak me të madhe për shkakë të punës dhe angazhimit, që ne të gjithë e dimë që e bejnë për sistemin shëndetsorë, është në interes të pacientave. Na kemi kerku me pasë një rritje ma të madhe dhe me u klasifiku ne bazë të punës dhe veprimit që e kryjmë, nuk kemi thenë që nuk mbështeten.

12.Pytjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar:

Nuk ka pasur.

13.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit

Z. Berat Ganiqi: javën a kaluar e kam pranuar një shqëtesim nga një qytetar i Pejës, kontribues i tri luftrave të fundit që janë zhvillu në trojet shqiptare, ky është Gjeladini Gashi puntorë në nderrmarrjen lokale të pastrimit “ Ambienti”. Gjeladini si rezultat i mos nenshtrimit të njerëzve atje të cilët e kanë kapë atë ndërmarrje, e ka marrë një vendim për shkputje të kontraës dhe largim nga puna. Nuk mendojë që njerëzit si Gjeladini që kanë kontribuar në të mirë të shtetit, pa u përzi në gjëra të pista, duhet me i largu nga puna, vetëm së nuk i nënshtrohen një kryeshefi ekzekutiv.Për fat të mirë ky kryeshef ka qelluar bashkëshorti i drejtoreshës së inspeksionit. Unë kërkojë me kompetencat që i ka kryetari, kompetencat që i ka nënkryetari, ky vendim mu tërheq mbrapa, sepse ai përjashtim është i jashtë ligjshem prej punës. Aty përsoni që është i akuzuar për keqpërdorim, akoma vazhdon me ushtru detyrën dhe pozitën e njejtë. Tek çështja tjetër që e ngriti z. Drini, çështjet e punësimeve është e vërtetë që këtu ndonjëher edhe nëse dikush i opozitës aplikon për vend të punës, duket që është shitur tek kryetari, tek subjekti. Mirëpo vet fakti që bashkëshortja e z. Drinit ka dalë ne vendin e 5, është elimini, ka dalë ne vendin e 22, tregon mjaftueshëm se çfarë hakëmarrje është bë. Si interesant të gjitha procedurat e rokrutimit i kalon motra e një drejtoreshë dhe punësohet e dinë në çfarë drejtorati.

Kryetari Z. Gazmend Muhaxheri: z. Gjeladini është ardhur dhe është ankuar edhe tek kryetari, por çështjen duhet me e adresu ligjerisht dhe kryetari e ka orientu me ju drejtu organeve, e ka këshillin e pavarur mbikqyrësë, gjykatën dhe krejt oragnet për me realizu të drejtën e vetë,jo me ardhë politikisht me e realizu një të drejt të vetës në punë. Ndërsa tek puna e punësimit kur te duash flasim, të njejtat punë jeni duke i bërë edhe ju në ndërmarrjen hidro drini, edhe në atë organin tjetër që e keni marrë, që jeni tu e udhëheqë tek patent shoferat, edhe ne e shohim kënd po e punësoni.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z.

Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën 12:20 h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalin zyrtarë në Youtube.

Kliko: <https://www.youtube.com/watch?v=ASUtPwzIUIM>

Procesmbajtësja,
znj. Donjeta Morina

KRYESUES I KUVENDI,
z. Rexhep Kurtbogaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS
MUNICIPALITY OF PEJA
OPŠTINA PEČ



ZYRA E KRYETARIT
MAYOR OFFICE
URED PRECEDNIKA

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr.03/L-40 të datës 20 Shkurt 2008 dhe nenit 52 të Statutit të Komunës së Pejës 01/2020 me numër protokolli L.nr. 01-016/01-413431/2020 i datës 30 shtator 2020, Kryetari i Komunës, z. Gazmend Muhaxheri 27.08.2024 pas shqyrtimit të rekomandimit të Drejtoratit për Buxhet dhe Financa të Draft – Buxhetin për Komunën e Pejës për vitet 2025- 2027, nxjerr këtë,

K o n k l u z i o n

I propozohet Komitetit për Politik dhe Financa ta shqyrton dhe t’ia rekomandon Kuvendit Komunal në Pejë, projekt buxhetit për Komunën e Pejës për vitet 2025- 2027.

Për implementimin e këtij Konkluzioni do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Konkluzioni dërgohet:

- Drejtoratit për Buxhet dhe Financa,
- Anëtarëve të KPF,
- Sekretarisë së Kuvendit Komunal Peje dhe
- Arhives

I.nr. 400 011 70644 /2024
Pejë, 27 Gusht 2024

KOMUNA E PEJËS



Planifikimi I Buxhetit 2025-2027

PAGA DHE MEDITJE

Programet	Plani stafit 2025	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
Totali I pagave		18,808,949.00	19,843,441.00	20,895,143.00
Zyra e Kryetarit	20	212,961.62	223,609.70	234,790.18
Administrata	59	411,981.20	432,580.26	454,209.27
ceshtjen gjinor	1	20,214.77	21,225.51	22,286.78
Integrimet Evropiane	1	11,225.82	11,787.11	12,376.47
Inspektimet	27	265,032.49	278,284.11	292,198.32
Prokurimi	4	35,224.30	36,985.51	38,834.79
Zyra e Kuvendit Komunal	35	243,987.49	256,186.87	268,996.21
Buxhetimi	33	259,354.40	272,322.12	285,938.23
Infrastruktura Rrugore	14	133,040.84	139,692.88	146,677.52
Zjarrfikësit dhe inspektimet	40	364,548.44	382,775.86	401,914.66
Zyra e komuniteteve	8	60,410.81	63,431.35	66,602.92
Bujqësia	23	151,891.19	164,199.98	172,409.98
Planifikim i Zhvillimit Ekonomik	6	59,837.93	62,829.83	65,971.32
Kadastra dhe Gjeodezia	18	154,400.05	162,120.06	170,226.06
Çështjet ligjore	5	48,509.02	50,934.84	53,481.58
Planifikimi urban dhe inspeksioni	12	117,833.02	123,724.67	129,910.91
Administrata (SH)	4	33,035.24	34,687.00	36,421.35
Shërbimet e shëndetësisë primare	354	3,666,076.54	3,849,380.00	4,041,849.01
Shërbimet sociale	20	154,801.50	162,541.58	170,668.66
shërbimet rezidenciale	10	52,500.00	55,125.00	57,881.25
Shërbimet kulturore	35	274,955.20	288,702.92	303,138.07
Teatri - Pejë	22	182,519.14	191,645.10	201,227.36
Administrata (A)	15	124,989.39	131,238.86	137,800.80
Arsimi parashkollor dhe qerdhet	90	735,007.14	771,757.50	821,921.73
Arsimi fillor	975	8,012,711.45	8,501,486.85	8,953,553.86
Arsimi i mesëm	377	3,021,900.00	3,174,185.52	3,353,855.71

TOTALI**2208****18,808,949.00****19,843,441.00****20,895,143.00**

MALLERA SHERBIME**Zyra e Kryetarit**

Kodet	2025	2026	2027
Akomodimi gjate udhetimit zyrtar jashte vendit	2,500.00 €	2,500.00 €	5,000.00 €
Akomodimi	5,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €
Sherbimet e perfaqesimit dhe avokatures	50,000.00 €	50,000.00 €	50,000.00 €
Drekat zyrtare	15,000.00 €	15,000.00 €	15,000.00 €
Total	72,500.00 €	72,500.00 €	75,000.00 €

Asambleja Komunale

Kodet	2025	2026	2027
Shpenzimet e udhetimit jashtë vendit	4,000.00 €	4,000.00 €	4,000.00 €
Akomodimi gjate udhetimit zyrtar jashte vendit	4,000.00 €	4,000.00 €	4,000.00 €
Shërbimet tjera kontraktuese	30,000.00 €	45,000.00 €	45,000.00 €
Furnizime për zyre	3,000.00 €	3,000.00 €	3,000.00 €
Drekat zyrtare	3,000.00 €	3,000.00 €	3,000.00 €
Total	44,000.00 €	59,000.00 €	59,000.00 €

Administrata dhe Personeli

Kodet	2025	2026	2027
Shpenzimet tjera telefonike - Vala 900, Ipko	26,000.00 €	24,000.00 €	24,000.00 €
Shërbimet tjera kontraktuese	1,900,000.00 €	1,900,000.00 €	1,916,500.00 €
Paisje tjera	3,000.00 €	7,000.00 €	9,000.00 €
Furnizime për zyre	18,000.00 €	20,000.00 €	20,000.00 €
Drekat zyrtare	6,000.00 €	6,000.00 €	6,000.00 €
Internet		3,000.00 €	3,000.00 €
Shpenzime postare	2,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
Mobile	1,000.00 €	9,000.00 €	9,000.00 €
Furnizim pastrimi	18,000.00 €	15,000.00 €	15,000.00 €
Vaj/antifriz	2,000.00 €	5,000.00 €	7,000.00 €
Naftë për ngrohje qendrore	119,000.00 €	120,000.00 €	140,000.00 €
Derivate për gjenerator	3,000.00 €	3,000.00 €	3,000.00 €
Karburant për vetura	116,000.00 €	100,000.00 €	100,000.00 €
Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve	34,000.00 €	50,000.00 €	50,000.00 €
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve.	30,000.00 €	50,000.00 €	50,000.00 €
Mirëmbajtja e ndërtesave	30,000.00 €	40,000.00 €	50,000.00 €
Mirëmbajtja e paisjeve	5,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €
Total	2,313,000.00 €	2,358,000.00 €	2,408,500.00 €

Integrime dhe Diaspore

Kodet	2025	2026	2027
Shpenzimet e udhetimit jashtë vendit	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
Shërbimet tjera kontraktuese		1,000.00 €	1,000.00 €

Drekat zyrtare	800.00 €	800.00 €	800.00 €
Total	1,800.00 €	2,800.00 €	2,800.00 €

Çeshtjet Gjinore

Kodet	2025	2026	2027
Shërbimet tjera kontraktuese	6,000.00 €	6,300.00 €	2,500.00 €
Furnizime për zyre	500.00 €	500.00 €	500.00 €
Drekat zyrtare	3,500.00 €	3,500.00 €	3,500.00 €
Total	10,000.00 €	10,300.00 €	6,500.00 €

Inspeksioni

Kodet	2025	2026	2027
Shërbimet tjera kontraktuese	63,000.00 €	63,000.00 €	63,000.00 €
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve.	5,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €
Furnizime për zyre			
Drekat zyrtare	2,500.00 €	2,500.00 €	2,500.00 €
Bllombat	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
Total	71,500.00 €	71,500.00 €	71,500.00 €

Prokurimi

Kodet	2025	2026	2027
Drekat zyrtare	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
Total	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €

Buxhet dhe Financa

Kodet	2025	2026	2027
Sherbime postare	22,000.00 €	25,000.00 €	25,000.00 €
Shpenzimet për anëtarësim	35,000.00 €	25,000.00 €	28,000.00 €
Total	57,000.00 €	50,000.00 €	53,000.00 €

ZLK

Kodet	2025	2026	2027
Shërbimet tjera kontraktuese	4,000.00 €	5,000.00 €	5,000.00 €
Inventar	4,000.00 €	4,000.00 €	4,000.00 €
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar	2,500.00 €	2,500.00 €	2,500.00 €
Furnizim për zyre	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
Drekat zyrtare	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
Total	12,500.00 €	13,500.00 €	13,500.00 €

Sherbime Publike

Kodet	2025	2026	2027
Shërbimet tjera kontraktuese -Hartimi I Proje	195,000.00 €	150,000.00 €	150,000.00 €
Pagat e mbikeq te projekteve	50,000.00 €	46,800.00 €	23,400.00 €
Drekat zyrtare	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
Mirembajtja dimerore (pastrimi i rrugeve nga	70,000.00 €	80,000.00 €	80,000.00 €
Mirmbajtja e rrugeve ne qytet	370,000.00 €	352,000.00 €	352,000.00 €
Mirembajtja e ndricimit publik	161,000.00 €	140,000.00 €	160,000.00 €
Shenjat e komunikacionit	70,000.00 €	50,000.00 €	50,000.00 €
Mirmbajta dimrore e rrugeve ne fshat dhe ru	70,000.00 €	227,723.00 €	232,223.00 €
Mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore ne Rug	95,000.00 €	80,000.00 €	85,000.00 €
Total	1,082,000.00 €	1,127,523.00 €	1,133,623.00 €

Emergjence

Kodet	2025	2026	2027
Shërbimet tjera kontraktuese	4,000.00 €	7,000.00 €	7,000.00 €
Furnizime për zyre	2,000.00 €	2,000.00 €	2,000.00 €
Drekat zyrtare	1,500.00 €	1,500.00 €	1,500.00 €
Furnizim me ushqim dhe pije	500.00 €	500.00 €	500.00 €
Karburant për vetura	13,000.00 €	13,000.00 €	13,000.00 €
Regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve	6,500.00 €	6,500.00 €	6,500.00 €
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve.	18,000.00 €	15,000.00 €	15,000.00 €
Mirëmbajtja e ndërtesave	1,000.00 €	1,000.00 €	1,000.00 €
Total	46,500.00 €	46,500.00 €	46,500.00 €

Bujqesi

Kodet	2025	2026	2027
Shërbimet tjera kontraktuese	75,000.00 €	65,000.00 €	65,000.00 €
Furnizime për zyre	1,000.00 €	2,000.00 €	2,000.00 €
në përputhje të plotë me Projektin Ideor “Çarshia e Gjatë” - Pejë të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve dhe shprehi vullnetin që të hyjë në proces të Këmbimit sipas dispozitave ligjore në fuqi në Kosovë. Po ashtu deklaroj se pajtohem me Vlerësimin e pronave të paluajtshme të cilin do të bëjë Zyra e Tatimit në Pronë në kuadër të Ministrisë e Financave në Prishtinë, dhe do të pajtohem me çmimin e vlerësimit të pronës së lartcekur nga po kjo Zyre e Vlerësimit”.

PALA
Sali Qelaj



Zyrtar i Lartë Ligjor për
Çështje Pronësoro-Juridike
Albion Kelmendi





Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Komuna e Pejës

DRAFT-PLANI I VEPRIMIT KUNDËR BRAKTISJES DHE MOSREGJISTRIMIT TË SHKOLLËS

2024-26

2024

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	
Hyrie	
Konteksti.....	
Qëllimi i planit të veprimi.....	
Objektivat	
Shtojca.....	

Shkurtesat

MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
DKA	Drejtoritë Komunale të Arsimit
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informacioneve në Arsim
EPRBM	Ekipi për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit
KN	Këshilli i nxënësve
KP	Këshilli i prindërve
KPAK	Komiteti i Prindërve të Arsimit të Kosovës
QPS	Qendra për Punë Sociale
OJQ	Organizatë Joqeveritare
UNICEF	Fondi Ndërkombëtar për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara
ECMI	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve

HYRJE

Janë një varg konventash dhe standardesh ndërkombëtare, të cilat kërkojnë qasje dhe mundësi të barabartë në arsim cilësor, prandaj shteti ka detyrim të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar të drejtën e arsimit për të gjithë qytetarët e vet pa dallim gjinie, etnie, aftësie e gjendje tjetër.

Meqë po flasim për shkollat dhe nxënësit/ fëmijët e arsimit parauniversitar, po i referohemi ekskluzivisht **Konventës për të Drejtat e Fëmijës**, si traktati që i mbulon në mënyrë gjithëpërfshirëse të drejtat e fëmijës në çdo cep të botës. Duke u thirrur në parimet bazë të kësaj konvente, shtetet orientojnë politikatat nacionale, prandaj ato janë bazamenti i të drejtave universale për çdo fëmijë/ individ. **Mosdiskriminimi, Pjesëmarrja, Interesi më i lartë i fëmijës dhe Zhvillimi i potencialit të plotë.**

Bazuar në këto parime, institucionet arsimore duhet të kujdesen për pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje në arsim cilësor, duke siguruar zhvillimin e fëmijëve brenda potencialit të plotë.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Nenin 47) dhe legjislacioni i arsimit garantojnë të drejtën e arsimit për të gjithë pa dallim gjinie, etnie, aftësie a gjendje tjetër, duke pasur për bazë të drejtat e njeriut/ fëmijës.

Ligjet aktuale: Ligji për Edukimin Parashkollor, Ligji për Arsimin Parauniversitar, Ligji për Arsim dhe Aftësim Profesional, Ligji për arsimin dhe aftësimin për të rritur, Ligji për Ligji për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë, Ligji për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, etj, bashkë me aktet nënligjore përcjellëse adresojnë mundësitë e barabarta dhe qasjen e gjithëpërfshirëse në arsim cilësor.

Barrierat e natyrave të ndryshme brenda sistemit arsimor, sidomos ato të qasjes në arsim, ndërlidhur me faktorët e shumtë individuale, familjarë, shoqërorë me kontekste të ndryshme sociale, ekonomike, shëndetësore e kulturore, kërkojnë qasje multidisiplinare, prandaj i kemi ligjet tjera relevante si: Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, Kodi i Përkohshëm i Procedurës

Penale, Ligji i Policisë, shëndetësisë etj, që bashkë me rregulloret dhe mekanizmat tjerë institucionalë, na e kërkojnë bashkëveprimin e plotë për të funksionuar si hallka të shtetit në adresimin e problemeve me të cilat ballafaqohemi.

Legjislacioni i arsimit, obligon institucionet përgjegjëse si: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, komnatat, institucionet arsimore dhe komunitetin, që të marrin të gjitha hapat e arsyeshëm që institucionet arsimore të jenë cilësore, gjithëpërfshirëse, humane dhe të sigurt, siç e kërkojnë politikat arsimore, përfshirë standardet për shkollat mike, kurrikulat dhe secila hallkë e sistemit arsimor. Janë një varg aktesh nënligjore që ndihmojnë zhvillimin e procedurave për sigurimin e qasjes e barabartë në arsim, zbatimin e ligjeve në fuqi.

Pastaj kemi dokumentet strategjike relevante që për prioritet kanë pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen në arsim, si dhe dokumentet tjera strategjike ndërsektoriale dhe procedurat standarde që adresojnë aspektet e qasjes në arsim të viktimave të trafikimit, dhunës, krimit dhe trethanave tjera çfarëdo qofshin ato.

Në funksion të zbatimit të këtyre politikave dhe konkretisht në adresimin e pjesëmarrjes në arsim ne me këtë plan komunal përqendrojmë vëmendjen te parandalimi dhe reagimi ndaj raktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, për të siguruar që të gjithë femijët, të jenë përfshues të sistemit arsimor dhe të zhvillohen brenda potencialit të plotë.

Konteksti

Drejtoria Komunale e Arsimit ka për qëllim krijimin e kushteve për edukim cilësor të të gjithë nxënësve dhe avancim të vazhdueshëm profesional të mësimit në përfundim me Kornizën e Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Kosovës.

Në Komunën e Pejës vijojnë mësimit 16.284 nxënës në 26 shkolla fillore të mesme të ulëta, në 6 shkolla të mesme të larta dhe në një institucion parashkollor. Në mësimit janë të përfshirë 1450 mësimit prej të cilëve 931 femra dhe 519 meshkuj.

Numri nxënësve braktisës brenda një viti shkollor sillejt deri 45 nxënës, kryesisht në shkollat e mesme profesionale dhe në shkolla që kanë nxënës të komuniteteve të ndryshme. Nxënës me aftësi të kufizuar të cilët vijojnë mësimit në ShFMU dhe ShML janë gjithësej 99.

Me qëllim të ofrimit të përkrahjes profesionale në shumicën e shkollave janë të punësuar psikolog dhe asistent të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore të cilët bashkëpunojnë edhe me Ekipin Komunal për Vlerësim Pedagogjik të fëmijëve me NEV.

Në bashkëpunim me OJQ dhe DKA funksionojnë tri Qendra të Karrierës të cilat ndihmojnë nxënësit për orientimin e tyre profesional. Në të gjitha ShFMU dhe ShML janë të themeluara EPRBM. Funksionimi i rregullt i EPRBM-ve ballafaqohet me sfida të shumta të cilat përfshijnë natyrën e punës në terren, koordinimin e domosdoshëm ndërinstitucional, trajnimet e vazhdueshme të ekipeve, takimet me prindër dhe nxënës e shumë angazhime të tjera, të cilat kanë edhe implikime buxhetore.

Me qëllim të funksionimit sa më të mirë të këtyre EPRBM-ve, grupi punues në nivel komune bazuar në objektivat e Planit Komunal të Veprimtari për periudhën kohore 3 vjeçare (2024-2026) ka planifikuar këto aktivitete:

Qëllimi i planit të punës

Koordinimi i veprimeve ndërinstitutionale dhe ngritja e kapaciteteve në nivel lokal dhe shkollor në zbatim të detyrimeve ligjore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, duke ritur përfshirjen e fëmijëve në arsim dhe zvogëlimin e braktisjes.

Objektivat e Planit Komunal të Veprimit

- **Objektiva e përgjithshme I:** Parandalimi dhe Identifikimi i hershëm i nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për ti mbështetur ata, si këshillim, mbështetje dhe mentorim

Objektivat specifike:

- 1.1 Funkcionalizimi i EPRRMve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune;
- 1.2 Koordinimi ndërinstitutional dhe me partnerë zhvillimorë në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave;
- 1.3 Monitorimi i progresi akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.

- **Objektiva e përgjithshme II:** Ujia e përqindjes së e braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës që përputhen me aftësitë, dhe interesat e nxënësve

Objektivat specifike:

2.1. Urëzimi mes shkollës së mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 6-të

2.2. Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orinetimin në profile sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës;

2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës

2.4. Monitorimi i zbatimit të planit të veprimi.

Këto objektiva janë detajuar me aktivitete, indikatorë, afate kohore, institucione përgjegjëse dhe mbështetëse, si dhe me buxhetin e planifikuar, ashtu që lehtësisht monitorohen në faza periodike.

Rezultatet kryesore të pretenduarra:

- Rritja e monitorimit dhe mbikëqyrjes nga inspektorati
- Funkcionalizimi i EPRMB në Komunë dhe në të gjitha shkollat
- Në fund të secilit vit pretendojmë rezultate konkrete për numrin / përqindjen e rasteve të zgjidhura
- Përgjigjja ndaj rasteve të nx. të panotuar dhe me shumë mungesa
- Rritja e raportimit cilësor nga shkollat/ zvoqëlimi i braktisjes

Buxheti: (Plotësohet tutje)

Buxheti i paraparë në këtë plan arrin deri në 32,700.00 € për 3 vite.

Monitorimi:

Zbatimin e këtij plani e monitoron EPRBM komunale, e cila bën raport vjetor mbi zbatimin e planit. Ky plan veprimi do të shoqërohet me kornizë monitoruese, e cila do ta lehtësojë procesin e monitorimit dhe raportimin në afatet e përcaktuara, gjashhtëmujore dhe vjetore.

Objektiva e përgjithshme 1. Fuqizimi i EPRBMve për parandalim dhe identifikim të hershëm të nxënësve në rrezik të braktisjes dhe ofrimi i ndërhyrjeve të duhura për t'i mbështetur ato, si këshillim, mbështetje dhe mentorim

Objektiva specifike 1.1: Funkcionalizimi i EPRBMve komunale dhe shkollore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i braktisjes në nivel komune

Nr.	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
1.1.1	Funksionalizimi i EPRBM-së komunale me takime dhe raportime të rregullta	Vendimi, procesverbalet, agjendat	X	X	X	DKA	Komuna MASHTI	1,500.00 euro (kompensimi i antarëve të ekipit për tri vite)
1.1.2.	Themelimi i EPRBM në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar	Vendimet e EPRBM-ve shkollore Procesverbalet nga puna në teren	X	X	X	DKA Shkolla	MASHTI Partnerët DKA	0.00 €
1.1.3	Seanca mbështetëse për EPRBM-në	Agjendat, listat e pjesëmarrjes	X	X	X	DKA	MASHTI Partnerët	1,500.00 €

	komunale								
1.1.4	Searca mbështetëse për EPRBM-të shkollore(trajnim për EPRBM shkollore)	Agjendat, listat e pjesëmarrjes	X	X	X	DKA	MASHTI Partnerët	1,000.00 €	
1.1.5.	Asistimi i EPRBM-ve shkollore për përdorimine SPH-së	Nr. i takimeve, nr. i shkollave përfituese 32 ShFMU dhe ShML	X	X	X	DKA	MASHTI Partnerët	0.00 €	
1.1.6.									

Objektiva specifike 1.2: Koordinimi ndërinstitutional dhe me partnerë zhvillimorë në mbështetjen e aktiviteteve të shkollave dhe nxënësve në nevojë

Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
		2024	2025	2026			
1.2.1 Takime koordinues me partnerë	Nr. i takimeve(2-3 takime gjatë vitit-listat e pjesëmarrjes), Rezultatet	X	X	X	DKA Qendrat e karrieres	MASHTI Partnerët	0.00 €

		Procesverbalet				OJQ		
1.2.2	Zhvillimi i projekteve ndërkulturore në parandalim të dukurive negative që e sftdojnë vijimin e rregullt të shkollës të gupëve të caktuara të nxënësve	Nr. i projekteve dhe aktiviteteve ndërgjegjësuere Nr. i shkollave përfituese 32 Nr. i nxënësve për fitues (kl VIII,IX,X,XI,XIII)	X	X	X	DKA Shkolla	DKA, DSHMS, Policia ,Zyra për Komunitete dhe Kthim ,Partnerët	600.00 €
1.2.3	Mbështetja e nxënësve me bursa dhe stimuj	Bursa për drejtime deficitare Bursa për nxënësit e	X	X	X	DKA MASHITI	Partnerët	8,000.00 € per transport (për

	të tjere (shpërblime) për motivimin e shkollimit të qëndrueshëm.	komuniteti REA 5 nxënës në shkollën e mjekësisë (Mashiti) për një vit Transporti i nxënësve në shkollat me rrezikshmëri të shuarjes (shkolla ekonomike)							tri vite
1.2.4.									
Objektiva specifike 1.3: Monitorimi i progresi akademik dhe joakademik i nxënësve dhe t'u ofrohet atyre mbështetje kur është e nevojshme.									
Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti		
		2024	2025	2026					
1.3.1. Zhvillimi i një sistemi të regjistrimit kumulativ për nxënësit e klasave 6-9	Plani i veprimit Regjistri i zhvilluar per nxënësit në trezik të braktisjes	X	X	X	DKA shkollat	MASHTI Partnerët	0.00 €		

Plani komunal i veprimt kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2023-25

	Raportet tremujore							
1.3.2.	Sigurimi i trajnimeve për mësuesit dhe administratorët e shkollave se si të mûrëmbajnë dhe përdorin sistemin e regjistrimit kumulativ;	Trajnimet e zhvilluara	X	X	X	DKA MASHTI	Partnerët	300.00 € (për tri vite)
1.3.3	Takimet e rregullta me prindërit, mësuesit dhe administratorët e shkollave për të rishikuar përparimin akademik dhe joakademik të nxënësve	Takimet e realizuara çdo tre muaj nga një takim (varesisht nga rastet dhe specifike të rasti) Procesverbalet nga takimi	X	X	X	Shkollat	DKA	0.00 €
1.3.4	Sigurimi i fondeve për aktivitetet mbështetëse për nxënësit që kanë vështirësi akademike ose personale;	Buxheti i ndarë Aktivitete e realizuara Seanca me psikologun shkollor per trajtimin e	X	X	X	DKA shkollat	MASHTI MEF	3,000.00 € (per tri vite materiale për dhomat e burimeve)

		veshtiresive personale të nxënësve							
		Organizimi i mësimit shpeshë dhe fuqizimi i klasëve per mesim intenziv							
1.3.5.	Zbatimi i sistemit kombëtar për identifikimin dhe adresimin e faktorëve të rrezikut për braktisjen e shkollës, si mungesat në shkollë, performancë e dobët akademike dhe gëshjtjet e sjelljes.	SPH funksional dhe i përdorshëm nga të gjitha shkollat Takime përkrahëse nga DKA per raportim te rasteve	X	X	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	0.00 €	

Objektiva e përgjithshme 2. Ujja e përqindjes së e braktisjes së shkollës duke krijuar një tranzicion të lehtë nga shkolla e mesme e ulët në shkollën e mesme të lartë, bazuar në mundësitë e karrierës që përputhen me aftësitë, dhe

interesat e nxënësve.

Objektiva specifike 2.1: Urëzimi mes shkollës së mesme të ulët me shkollën e mesme të lartë duke filluar nga klasa e 6-të

Nr.	Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
2.1.1	Zbatimi i politikave për orientimin në karrierë në fazat e hershme dhe me fokus për nxënësit e klasës së 6-të.	U.A i zbatueshëm Aktivitet e rregullta, të realizuara	X	X	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	0.00 €
2.1.2.	Organizimi i panairove të karrierës për t'i ekspozuar nxënësve para profesioneve të ndryshme dhe mundësi	Panairot e realizuara	X	X	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	1,500.00 € (tri vite)

	punësimi.							
2.1.3	Angazhimi i këshilltarëve për orientimin në karrierë në shkollat e mesme të ulëta për t'u ofruar nxënësve këshilla dhe mbështetje profesionale.	Nr. i këshilltarëve të karrierës të punësuar në shkolla 26 këshilltarë të karrieres	X	X	X	DKA	MASHTI	0.00 €
2.1.4	Hartimi i një programi që i ndihmon nxënësit në planifikimin e karrierës dhe vendimmarrjen, i cili përfshin lidhjen e tyre me shkollat e mesme të larta.	Programi i hartuar dhe i shpërndarë në shkolla, postera, fllajera ,fletëpalosje	X	X	X	Shkollat DKA Qendrat e Orientimit në Karrierë	MASHTI Partnerët	1,500.00 € (per tri vite)
2.1.5								
2.1.6								

Objektiva specifike 2.2: Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për orinetimin në profile sipas kompetencave dhe interesave të fëmijës

Aktivitetet	Treguesit	Afati kohor			Institucioni përgjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
		2024	2025	2026			
2.2.1	Përgatitja e materialeve informuese për prindër dhe nxënës.	Materialet e përgatitura (broshura, postera, video-mesazhe, etj.)	X	X	X	Shkollat DKA MASHTI Partnerët	1,500.00 € (per tri vite)
2.2.2	Punëtori me prindër për promovimin e profileve arsimore dhe përparësitë e orientimit të saktë të fëmijëve në shkollimin e mesëm	Nr. i punëtorive, takimeve të realizuara	X	X	X	Shkollat DKA MASHTI Partnerët	Sigurimi i transportit për Këshilltarët nga Qendrat e karrieres në shkolla 600.00 € (tri vite)
2.2.3	Seminare për nxënësit e shkollave të mesme të ulëta	Nr. i seminareve e realizuara me nxënës, takime me keshilltare të	X	X	X	Shkollat DKA MASHTI Partnerët	600.00 € (tri vite)

	për të eksploruar aftësitë, interesat dhe aftësitë e tyre.	karieres, kujdestar të klasës ,psikolog	Afati kohor			Institucioni përjegjës	Institucionet mbështetëse	Buxheti
			2024	2025	2026			
2.2.3.	Takime të përbashkëta me prindër, nxënës me folës motivues.	Numri i takimeve të realizuara Me psikologun e shkollës	X	X	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	600.00 € (tri vite)
<p>Objektiva specifike 2.3. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale për të ofruar mundësi të punës praktike, programe të mentorimit dhe mundësi për krijimin e vendeve të punës.</p>								
2.3.1.	Identifikimi i bizneseve dhe krijimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit	Nr. i marrëveshjeve dhe i partnerëve (rreth 40 marreveshje	X	X	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	0.00 €
2.3.2.	Zbatimi i marrëveshjeve të mirëkuptimit sipas	Nr. i shkollave dhe profileve përfituese të marrëveshjeve	X	X	X	Shkollat DKA	MASHTI Partnerët	10,500.00 €(sigurimi i nxënësve për punën praktike

Plani komunal i veprimtari kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës 2023-25

2.4.4.	Raportimi mbi zbatimin e planit të veprimtari	Raportimi i rregullt vjetor	X	X	X	DKA Shkollat	MASHITI Partnerët	0.00 €
--------	-----------------------------------------------	-----------------------------	---	---	---	-----------------	----------------------	--------

Shtojca : Korniza përkatëse ligjore, dokumentet e politikave dhe referencat shtesë

Ligjet

- Kushtetuta e Kosovës,
<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=3702>
- Ligji 04/L-032 për Arsimin parauniversitar në Kosovë, 16 shtator 2011, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770>
- Ligji nr. 2003/12 për Qasjen në dokumente zyrtare, 6 nëntor 2003, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2470>
- Ligji nr. 03/L – 172 për Mbrojtjen e të dhënave personale, 31 Maj 2010, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2676>
- Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e gjuhëve, 1 Mars 2007 <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2440>

Udhëzimet administrative

- Udhëzimi administrativ 08/2018 për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsiminparauniversitar <https://masht.rks-gov.net/udhezimi-administrativ-masht-mr-08-2018-per-themelimin-dhe-fuqizimin-e-ekipeve-parandalimdh-kmnapu/>
- Udhëzimi administrativ nr. 9/2011 për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave statistikore nga shkollat dhe institucionet parashkollore në arsimin parauniversitar duke përdorur sistemin për menaxhimin e informatave në arsim, 30 dhjetor 2012, <https://masht.rks-gov.net/9-ua-per-mbledhjen-dhe-raportimin-e-te-dhenave-statistikore-nga-shkollat-dhe-institucionet-parashkollore-ne-arsimimin-pauniversitar-duke-perdorur-sistemin-per-menaxhimin-e-informative-ne/>
- U.A për transferin e nxënësve <https://masht.rks-gov.net/16-ua-per-kalimin-e-nxenesit-te-shkolles-se-mesme-te-larte-prej-nje-profilli-arsimor-ne-tjetrin-prej-nje-shkolle-ne-shkollen-tjeter-nr-16-2011-date-30-12-2011/>

- U.A. 08/2022 për dokumentacionin shkollor të arsimit parauniversitar, <https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-masht-nr-08-per-dokumentacionin-shkollor-ne-arsimin-parauniversitar/>
- U.A. 03/2012 Barasvlera dhe njohja e dokumenteve të arsimit parauniversitar të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës <https://masht.rks-gov.net/ua-barasvlera-dhe-njohja-e-dokumenteve-te-arsimit-pauniversitar-te-leshuara-jashte-republikes-se-kosoves-nr-03-2012-date-02-05-2012/>
- U.A. 19/2015, Për sistemimin e nxënësve të cilët kanë migruar nga viti shkollor 2014/2015 <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-19-2015-per-sistemimin-e-nxenesve-te-cilet-kane-migruar-nga-viti-shkollor-2014-2015/>
- U.A. 1/2016, Përcaktimi i kushteve, kriterëve dhe procedurave për organizimin e mesimit plotësues për nxënësit e riadhesuar <https://masht.rks-gov.net/ua-nr-01-2016-dt-12-01-2016-per-percaktimin-e-kushteve-kritereve-dhe-procedurave-per-organizimin-e-mesimit-plotesues-per-nxenesit-e-riadhesuar-organizimi-dhe-planifikimi-i-procesit-arsimor-ne-ars/>
- U.A. 01/2014 për organizimin dhe planifikimin e AAP <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-01-2014-organizimi-dhe-planifikimi-i-procesit-arsimor-ne-arsimin-dhe-afesimin-profesional/>
- U.A. 02/2014 Numri i nxënësve me module dhe kualifikime të AAP, resurset, infrastrukturadhe siguria e nxënësve <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-02-2014-numri-i-nxenesve-me-module-dhe-kualifikime-te-aap-resurset-infrastruktura-shkollore-siguria-e-nxenesve/>
- UA (MASHT) Nr. 06.2014 Kodi i mirësjelljes dhe masat disiplinore për nxënësit të shkollave të mesme të larta <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10128>
- UA- MASHT Nr: 12/2014 Përiqashtimet në moshtë me rastin e regjistrimit në arsimin dhe aftësimin për të rritur <https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-12-2014-periqashtimet-ne-moshte-me-rastin-e-regjistrimit-ne-arsimin-dhe-afesimin-per-te-ritur/>

(Politika për mesimin dual ka filluar nga shtatori 2022 fillimisht në 4 profile: kuzhinier, asistent i restorantit, floktar dhe murator)

Ministria e Arsimit është e interesuar për sistemin dual të mësimi, me synimin që në secilën komunë të bashkëpunohet me bizneset që kanë mundësi punësimi për të rinjtë, duke u kujdesur për sigurinë në punë dhe çështjet që ndërlidhen me punën që e bëjnë nxënësit nën moshën 18 vjet.


Strategjitë kombëtare/planet e veprimtari

- Plani strategjik i arsimit në Kosovë (2022-2026),
- Strategjia për të drejtat e fëmijës (2019-2023),
- Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njëzë në Kosovë (2022-2026),
- Strategjia dhe plani i veprimtari për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare (2022-2026).

Të tjera

- *Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar* (MASHT, 2023)
- *Mundësi të Barabarta për arsim për të gjithë, Doracak për ekipet komunale për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në arsimin e obliguar* (MASHT, 2023)
- Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), *Trajtimi i refuzimit të shkollës dhe braktisjeve: doracak i orientuar kah praktika [Dealing with school refusal and dropouts: A practice-oriented manual]* (tetor 2011).
- Raporti i OSBE-së: *Përcjellja e braktisjes së shkollës dhe mosvijimit në Kosovë* <http://www.osce.org/sq/Kosovo/95113?download=true> (qasur më 24 mars 2014).
- *Regjistrimi dhe braktisja e shkollës nga vajzat në Kosovë* (MASHT & UNICEF2004).
- *Braktisja e shkollës nga nxënësit në Kosovë* (MASHT, 2008)

- Instituti Pedagogjik i Kosovës, *Femijët jashtë shkollës – Studim bazë për praktikën e parandalimit dhe të reagimit ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë* (2014)
- UNICEF, Përmbledhje e Politikave - *Të gjithë femijët regjistruhen, vijojnë dhe përfundojnë arsimimin*, 2014



Nr 20-91 Datë 24.10.2023

Bazuar nenin 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr 08/2018 për Themelimin dhe Fuqizimin e Ekipëve për Parandalim dhe Reagim Kundër Braktisjes dhe Mosregjistrimit të Nxënësve në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Arsimit bie këtë:

V E N D I M

I. Themelohet përbërja e grupit punues për Hartimin e Planit Komunal për Parandalim dhe Reagim kundër braktisjes dhe Mosregjistrimit të Nxënësve në Arsimin Parauniversitar në këtë përbërje:

1. Afërdita Spahija –Kryesuese
2. Shqipe Karagjyzi –Anëtare
3. Jehona Nallbani-Anëtare
4. Edona Ajdini-Anëtare
5. Gjemajli Kastrati –Anëtar

Obligohet Komisioni që punët të kryej me përgjegjësi të plotë sipas U.A 0/2018 të MASHT-it.

Vendimi u dërgohet: Të gjithë anëtarve

Drejtori

Naser Gega





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



DRAFT–R R E G U L L O R E Nr.XX/2024
PËR
SHËRBIMIN E TRANSPORTIT ME “MERIMANGË” NË TERRITORIN E
KOMUNËS SË PEJËS

Shtator, 2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

Nr.Prot: _____/2024

Data XX.xx.2024

Në kuptim të dispozitave të nenit 17 paragrafi 1 shkronja f) dhe n) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (GZ e RK Nr.28, dt.04.qershor 2008), të dispozitave të neneve 96, 99, 100, 101, 102 të Ligjit Nr.02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugorë (GZ e RK Nr.36, dt.25 gusht 2008), të dispozitave të nenit 6 të Ligjit Nr.04/L-179 për Transportin Rrugor (GZ e RK Nr.21 dt.13 qershor 2013), të dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2009-PK dhe dispozitave të nenit 20 paragrafi 1 nenparagrafi 1.3 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës I.Nr.01-016/01-413431/2020 dt.30 shtator 2020, Kuvendi i Komunës së Pejës në mbledhjen e mbajtur më datë XX.XX.2024, miratoi këtë:

DRAFT-RREGULLOREN Nr.XX/2024

PËR

**SHËRBIMIN E TRANSPORTIT ME “MERIMANGË” PËR TERRITORIN E
KOMUNËS SË PEJËS**

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Në bazë të kësaj Rregulloreje, rregullohen kushtet dhe mënyra e zhvendosjes së automjeteve të ndaluara ose të parkuara në rrugë, apo në hapësira tjera të ndaluara, ku rrezikohet siguria në komunikacion ose pengohet rrjedha normale e komunikacionit dhe ushtrimi i shërbimit të transportit me “merimangë” në territorin e komunës së Pejës.

Neni 2

1. Shërbimi i transportit me “merimangë”, nënkupton tërheqjen - bartjen e automjeteve të marra nga vendet ku është i ndaluar parkimi i tyre, nga vendet ku ka ndodhur aksidenti në komunikacion, automjetet që mund të jenë të braktisura dhe në raste të tjera, dhe vendosja e tyre në vendin e caktuar për këtë qëllim.

2.Pas konstatimit të shkeljes së rregullave në komunikacion, të evidencuar nga personat kompetent, se automjeti është ndaluar apo parkuar në mënyrë jo të rregullt, ai tërhiqet në bazë të urdhëresës së zyrtarit policor apo inspektoratit të komunës dhe kërkesës së personit të autorizuar nga organi i Komunës së Pejës.

3.Para se të jepet urdhëresa për zhvendosjen e automjetit, sipas paragrafit paraprak të këtij neni, pozita e automjetit të ndaluar ose parkuar në mënyrë jo të rregullt, dëshmohet me fotografi ose me skicë .

4.Vendin (lokacionin) për vendosjen e automjeteve në autopark, nga paragrafi paraprak, e cakton Komuna (Drejtoritë kompetente).

Zhvendosja dhe bllokimi

Neni 3

1.Tërheqja - bartja e automjeteve bëhet me urdhër dhe nën kontrollin e Policisë, të inspektorit komunal të komunikacionit, duke konstatuar gjendjen e automjetit para se të lëshohet urdhëresa për tërheqje.

2.Automjetet e ndaluara ose të parkuara në mënyrë jo të rregullt zhvendosen, ndërsa autobusët, automjetet transportuese, makinat dhe automjetet e punës dhe rimorkiot, tërhiqen në bazë të urdhëresës së zyrtarit policor dhe kërkesës së personit të autorizuar nga organet e Administratës komunale: inspektori i komunikacionit apo inspektori komunal, në bashkëpunim me Policinë.

3.Operatori i transportit me “merimangë”, do të caktohet përmes thirrjes të shpallur për kryerjen e shërbimeve të transportit me “merimangë”, në bazë të kushteve më të volitshme të ofruara.

Neni 4

1.Komuna do të lidhë kontratë me operatorin e transportit - fituesin e tenderit për transport me “merimangë”, me të cilin do t’i përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese.

2.Kontrata nga paragrafi paraprak, lidhet për kohë të caktuar deri në 3 vite, me mundësi vazhdimi.

Neni 5

1.Në momentin e tërheqjes - marrjes së automjetit nga operatori, përveç dëshmisë së pagesave, operatori duhet të kërkojë edhe dëshminë e pronësisë ose evidencën, se personi që kërkon lëshimin e automjetit ka qenë duke drejtuar atë para se të bllokohej, përkatësisht para se të jetë tërhequr në vendin e caktuar për këtë.

2.Operatorit i lejohet lëshimi i automjetit, kur pronari ose drejtuesi i automjetit ofron dëshminë e kërkuar sipas paragrafit paraprak dhe bën pagesën e taksës sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Obligimet dhe përgjegjësitë e operatorit

Neni 6

1.Operatori është përgjegjës të plotësojë të gjitha dokumentet e nevojshme gjatë kryerjes së sigurimit fizik të autoparkut të Komunës.

2.Afati për sigurimin e autoparkut zgjatë derisa zgjatë kontrata e tërheqjes.

3.Operatori është përgjegjës në rast keqpërdorimi, dëmtimi eventual gjatë ngarkimit -shkarkimit, bartjes deri në dorëzimin e automjetit në autoparkun komunal (dëmin eventual të shkaktuar duhet t'ia kompensojë pronarit të automjetit).

4.Pas dorëzimit dhe vendosjes së automjetit në parkingun komunal, përgjegjësia bie mbi personelin e sigurimit të autoparkut deri të bëhet tërheqjen e automjetit nga pronari.

Kushtet për shërbimin e transportit me “merimangë” Neni 7

1.Operatori i cili ushtron këtë veprimtari, duhet t'i plotësojë këto kushte:

- 1.1. Të jetë i regjistruar për ushtrimin e shërbimit të transportit me “merimangë”,
- 1.2. Të ketë së pakut dy automjete për bartjen e automjeteve,
- 1.3. Të ketë sistemin funksional të radio-lidhjeve,
- 1.4. Të sigurojë shërbimin 24-orësh, gjatë shtatë ditëve të javës,
- 1.5. Të ketë numër të mjaftueshëm të personelit për ushtrimin e veprimtarisë (për një automjet për bartje të ketë ngasësin dhe ndihmësin).

Kushtet për automjetet bartëse Neni 8

1.Automjetet duhet:

- 1.1 Të jenë të regjistruara,
- 1.2 Të jenë të dedikuara posaçërisht për bartjen e automjeteve, (njëri automjet duhet të jetë me vinç, të ketë katër mungenetë, të cilat duhet të vendosen në rrota të automjetit, kurse tjetri duhet të jetë me litar tërheqës (metalik), që ta bëjë ngarkimin e veturave),
- 1.3 Është e preferuar të kenë ngjyrë të njëjtë,
- 1.4 Në çdo kohë, të jenë në gjendje teknike të rregullt,
- 1.5 Ti kenë pajisjet e parapara për ushtrimin e kësaj veprimtarie,
- 1.6 Të kenë dritën rrotulluese me ngjyrë të verdhë të vendosur mbi automjet dhe
- 1.7 Të kenë shenjat përkatëse të komunikacionit.

Kushtet për drejtuesit e automjeteve Neni 9

1.Drejtuesit e automjeteve duhet:

- 1.1. Të jenë në marrëdhënie pune te operatori,
- 1.2. Të kenë patentën e shoferit të kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit përkatës,
- 1.3. Të kenë ndihmësin për kryerjen e bartjes.

Tarifa e shpenzimeve Neni 10

1.Tarifa e shpenzimeve për zhvendosjen e automjeteve, bllokimit dhe zhblokimit, si dhe ruajtja në vendin ku vendosen, është e përcaktuar si në vijim:

- 1.1. Për zhvendosjen e motoçikletës, traktorit dhe veturës pa rimorkio brenda qytetit, deri në vendin për vendosje dhe ruajtjen e tyre deri në 24 orë, tarifa e shpenzimeve është tridhjetë (35) €.
- 1.2. Tërheqja e automjetit transportues, rimorkios ose gjysmë rimorkios dhe autobusit brenda qytetit, deri në vendin për vendosje dhe ruajtja e tyre deri në 24 orë, kushton njëqind (100) €.
- 1.3 Zhvendosja e automjeteve nga paragrafi 1 i pikës 10.1, nga zona jashtë qytetit, pa ngarkesë, kushton 0.25 € për 1 km, ndërsa me ngarkesë 0.50 € për 1 km. Të njëjtat tarifa vlejnë edhe për paragrafin 2. të pikës 10.1.
- 1.4. Në rastin kur zhvendosja e automjetit vetëm fillon, por nuk bëhet zhvendosja deri në vendin e ruajtjes, zbatohet çmimi si vijon: në zonën urbane 15€.
- 1.5. Për zhbllokimin e automjeteve, autobusëve, automjeteve transportuese, automjeteve të punës dhe rimorkiove, duhet paguar 15 €.
- 1.6. Të gjitha pagesat nga paragrafi paraprak do të bëhen përmes bankës.
- 1.7. Për secilën pagesë do të lëshohet fatura, e cila do të jetë me numër rendor dhe do të përmbajë këto të dhëna:
 - 1.7.1. Markën dhe modelin e automjetit,
 - 1.7.2. Numrin e targave,
 - 1.7.3. Emrin e plotë, adresën dhe numrin personal të personit që i lirohet automjeti,
 - 1.7.4. Datën e bllokimit të automjetit,
 - 1.7.5. Datën e lirimit të automjetit dhe vendin e lirimit (në vendqëndrimin e automjeteve apo në vendin ku është bllokuar).

Puna me bllokues **Neni 11**

1. Sipas kësaj Rregulloreje, operatori duhet të jetë i pajisur me bllokues.
2. Sistemi i vendosjes së bllokuesve kryhet nga punëtorët e operatorit, në marrëveshje me policinë, në çdo kohë dhe në çdo vend.
3. Automjetit të cilit i vendosen bllokuesit, duhet të paguajë gjobën sipas nenit 10, paragrafi 10.4 të kësaj Rregulloreje.

Lirimi nga tarifa e pagesave **Neni 12**

1. Nga pagesa lirohen:
 - 1.1. Automjetet e zhvendosura ose automjetet që tërhiqen me rastin e konfiskimit nga ana e Policisë, me qëllim të verifikimit të dokumentacionit dhe të automjetit, në rast se verifikimi rezulton i rregullt;
 - 1.2. Automjetet e zhvendosura ose që tërhiqen, në rastet kur automjeti ka pësuar aksident dhe si pasojë ka ardhur deri te vdekja e personave në automjet dhe
 - 1.3. Automjetet e tërhequra nga Policia për shkaqe sigurie.
2. Si dëshmi e plotësimit të këtyre kriterëve të paragrafit paraprak, Policia, gjatë plotësimit të raportit, duhet shënuar arsyen e tërheqjes - marrjes së automjetit.

Neni 13

Në rast të shkeljes së ndonjërës nga dispozitat e kësaj Rregulloreje, Drejtoria mban të drejtën e shkëputjes së kontratës me operatorin ekonomik.

II. DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 14

Sipas kësaj rregulloreje, në asnjë rast, pas 72 orëve nga dita e marrjes së automjetit, komuna nuk mban përgjegjësi për mjetet që mbeten në parking pa u terhequr nga pronari apo operatori, komuna nuk përfiton pasoja ligjore pas këtij afati, që do të thotë se komuna lirohet nga përgjegjësia totale e çdo ankese apo konteksti ligjor, tutje operatori e zgjedh këtë me pronarin e mjetit.


Neni 15

Për të gjitha çështjet tjera, të cilat nuk janë paraparë në këtë Rregullore, do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr.02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor dhe dispozitat e Udhëzimit Administrative Nr.02/2009 - PK.

Neni 16

Kjo Rregullore shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ëeb-faqën e Komunës së Pejës.

Rexhep Kurtbogaj d.v.
Kryesues i Kuvendit të Komunës
Komuna e Pejës



DREJTORATI KOMUNAL I ARSIMIT

DATË/A:	09.09.2024
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryesusin e kuvendit Z.Rexhep Kurtbogaj, sekretarin Z.Avni Gashin
NGA/OD/FROM: DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit-Pejë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport për fillimin e vitit shkollor 2024/2025 në shkollat e Komunës së Pejës

Drejtoria Komunale e Arsimit raporton , se fillimi I vitit shkollor 2024/2025 në të gjitha shkollat e Komunës së Pejës filloj me dt 02.09.2024

Janë bërë këto përgatitje:

-Kontratat janë nënshkruar për furnizim me lëndë djegëse (dru ,pelet) dhe pritet që furnizimi të bëhet sipas dinamikës së kërkesave të shkollave.

-Është formuar komisioni për shqyrtimin e kërkesave për transportin e nxënësve sipas ligjit per arsim parauniversitar dhe gjithëpërfshirjen .

-Është bërë plotësimi I normave (orëve) të punës të gjithë mësimeve, e poashtu edhe të mësimeve të cilët kanë ngelë pa orë ,shkak i mbylljes së dy paraleleve të ndara në fshatin Broliq dhe Dobërdol.

Furnizimi I nxënësve me tekste shkollore është gati në përfundim .

Në të gjitha shkollat , regjistrimi i nxënësve në klasën e I-rë, klasën e 10-të ka përfunduar me sukses .

Për numrin e nxënësve në total në shkollat e komunës së Pejës do të informohemi pas përfundimit të regjistrimit në sistemin SMIA nga ana e drejtorëve të shkollave .



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 16 Shtator 2024 2024, në rekomandim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLUZION

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton dhe miraton vendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Pejës 2025-2027, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 400-0170644
Pejë, date: 16 Shtator 2024

KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-

KRYESUES I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 16 Shtator 2024, në rekomandim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton dhe miraton propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Fatmir Zymberi, me qëllim të përmbushjes së interesit publik, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 463/01-74093
Pejë, date: 16 Shtator 2024

KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-

KRYESUESI KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 16 Shtator 2024, në rekomandim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton dhe miraton propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ajmon Sefa, me qëllim të përmbushjes së interesit publik, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 463/01-74089
Pejë, date: 16 Shtator 2024

KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-

KRYESUESI KUVENDIT,
Z. Rexhep Kurtbogaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 16 Shtator 2024, në rekomandim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton dhe miraton propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Sali (Shaban) Qelaj, me qëllim të përmbushjes së interesit publik, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 463/01-74082
Pejë, date: 16 Shtator 2024

KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-

KRYESUESI KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 16 Shtator 2024, në rekomandim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton dhe miraton propozimin e Drejtorisë së Administratës dhe Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e kryesuesve të Këshillave Lokale për vitin 2023 dhe 2024, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 400/01-74419
Pejë, date: 16 Shtator 2024

KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-

KRYESUESI KUVENDIT,
Z. Rexhep Kurtbogaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 16 Shtator 2024 2024, në rekomandim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton dhe miraton propozimin e Kryetarit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të KKSb-së për vitin 2023 dhe 2024, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 400/01-74427
Pejë, date: 16 Shtator 2024

KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-

KRYESUESI KUVENDIT,
Z. Rexhep Kurtbogaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 16 Shtator 2024, në rekomandim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLuzion

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton dhe miraton propozimin për dhënie në diskutim publik të Draft Rregulloren për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 400-01/74424
Pejë, date: 16 Shtator 2024

KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-

KRYESUESI KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takim e mbajtur me datë: 16 Shtator 2024, në rekomandim të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, nixjerrë këtë:

KONKLUZION

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton dhe miraton propozimin e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës për kompensimin e anëtareve të Komiteteve Konsultative për vitin 2023 dhe 2024, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër: 400/01-76384
Pejë, date: 16 Shtator 2024

KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-

KRYESUES I KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ



Në bazë të nenit 52. pika 2. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28.datë: 04. Qershor 2008”) , nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4. dhe nenit 42, të Statutit Nr. 01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431 datë : 30. Shtator 2020, Komiteti për Politikë e Financa, në takimin e mbajtur me datë: 16 Shtator 2024 2024, në rekomandim të Kryetarit Komunës së Pejës, nxjerrë këtë:

KONKLUZION

I REKOMANDOHET Kuvendit Komunal Pejë, të shqyrton dhe miraton propozimin për dhënie në diskutim publik të Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026, siç u është prezantuar anëtareve të kuvendit në material për takim.

I. Numër:
Pejë, date: 16 Shtator 2024

KUVENDI KOMUNAL PEJË
-Komiteti për Politikë e Financa-

KRYESUESI KUVENDIT,
z. Rexhep Kurtbogaj

